

Nr. .... Prot  
*Lutemi referoni këtë numër në përgjigje*

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_. 2022

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**Drejtuar:** Operatorit Ekonomik “Infosoft Systems” sh.p.k, NIPT J61820021C, me adresë: Rruga “Murat Toptani”, Godina “Gjergji Center”, Tiranë.

**Procedura e prokurimit/lotit:** Procedurë e hapur - shërbime.

**Numri i procedurës / referenca e Lotit:** **NR.REF-31628-06-02-2022.**

**Përshkrimi i shkurtër i kontratës:** “Furnizim vendosje dhe instalim i infrastrukturës server të konvergjuar me teknologji virtualizimi”.

#### **Kohëzgjatja e kontratës:**

✚ **Afati kohor** për furnizimin dhe implementimin do të jetë 4 (katër) muaj, nga data e nënshkrimit të kontratës.

✚ **Mirëmbajtja** do të jetë 1 (një) vit nga momenti i lëshimit të Çertifikatës së marrjes në dorëzim të sistemit.

**Publikimet e mëparshme:** Buletini i Njoftimeve Publike Nr.72, datë 06/06/2022.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1- Operatori Ekonomik “Infosoft Systems” sh.p.k, NIPT J61820021C, me ofertë ekonomike 38,383,643 (Tridhjetë e tetë milion e treqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e dyzetë e tre) Lekë pa TVSH.

2- Operatori Ekonomik “DIVITECH” sh.p.k, NIPT L01306049O, me ofertë ekonomike 39,627,600 (Tridhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e njëzetë e shtatë mijë e gjashtëqind) Lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

I- Operatori Ekonomik “DIVITECH” sh.p.k, NIPT L01306049O, pasi:

✚ Nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, sipas shtojcës 3;

✚ Nuk plotëson kriterin për kualifikim pika 2.3.2 kapaciteti teknik, pasi nuk ka paraqitur çertifikatën ISO 27001:2013 “Sistemi i menaxhimit të sigurisë informatike”.

✚ Nuk plotëson pikën 2.3.4 kapaciteti teknik, pasi në formularin përmbledhës të vetë deklaramit nuk rezulton të ketë punonjës me çertifikimet e kërkuara sipas pikës 2.3.4.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “Infosoft Systems” sh.p.k, NIPT J61820021C, me adresë: Rruga “Murat Toptani”, Godina “Gjergji Center” Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 38,383,643 (Tridhjetë e tetë milion e treqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e dyzetë e tre) Lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Ergys Verdho**